



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.102/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në hapësira publike, të kandidatës për Kryeministre Vjosa Osmani, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

VE N D I M

Pranohet ankesa e A.nr. 102/2019 e datës 26.09.2019, e paraqitur nga Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 6,100.00 euro (gjashtë mijë e njëqind), të cilën gjobë subjekti politik detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga pranimi i këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2019, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 26 Shtator 2019 në orën 14:00, në sheshin “Shadërvan” të qytetit të Prizrenit, kanë vërejtur se aktivistët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), kanë vendosur në lloj tavoline me disa postera të kandidatës së tyre për kryeministre Vjosa osmani. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 33 pika b) të LZP-së, dhe po ashtu shkelje e Rregullores Nr.13/2013, “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, përkatësisht nenit 3.4 dhe nenit 4 pika b. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë të datës 27.09.2019, subjekti politik LDK, thekson se ankesa e paraqitur nga subjekti politik LVV, Anr.102/2019, e datës 27.09.2019 është e pabazë, sepse në kushte dhe rrethana në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, duke pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur që ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore, vendosja e tendës lëvizëse nuk duhej të trajtohej si shkelje, dhe se shkelja e dispozitës ligjore të LZP-së, gjegjësisht neni 33 pika b) nuk qëndron ngase në foto dëshmi nuk shihet pothuajse asgjë. Subjekti politik LDK, propozon që ankesa e paraqitur nga Subjekti politik LVV të hudhet si e palejuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se materialet zgjedhore-posterat e kandidatës

për kryeministre nga radhët e subjektit politik LDK Vjosa Osmani, janë të vendosur në hapësirat publike-rrugë, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Këtë shkelje subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk e ka pranuar në përgjigjen në ankesë të datës 27.09.2019.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Faktin se subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtat janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t’u përgjigjur dhe ta përmirëson shkeljen në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika a) e LZP-së, mirëpo subjekti politik nuk e ka ndërmarr asnjë veprim për përmirësimin e shkeljes, me arsyetimin se në kushte dhe rrethana në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, komunat nuk kanë arritur që të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e subjektit politik LDK, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara në ligj dhe të pa qëndrueshme si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, ne kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika C të LZP-së dhe nenit 3 paragrafi 2 Rregullës Nr. 01/2012, Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjjobave të PZAP-it.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 102/2019 më datën 30.09.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.